

VENDIM
Nr.802, datë 17.4.2009

PËR DHËNIE LICENCE PËR TELEVISIONIN VENDOR PRIVAT “TV JUG”
SUBJEKTIT: “INTELMEDIA” SHPK

Në mbështetje të ligjit nr.8410, dtë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurën e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, të zonave dhe frekuencave të lira të shpallura publikisht në datën 4.3.2009, sipas vendimit nr.779, datë 25.2.2009 të KKRT-së, si dhe kërkesës së subjektit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1.T’i japë subjektit “INTERMEDIA” sh.p.k., licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv vendor privat, në fushën e transmetimeve tokësore analoge për një periudhë prej 5 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal zonën e qytetit të Fierit.

2.Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

3.Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Mesila Doda (Demi)